REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 215/19
16.05.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Autoritetin Kontraktues Komuna e Suharekës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: Nr1 i prokurimit 624-19-314-2-2-1

Nr i brendshëm 624-019-007-221

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në teritorin e Komunes se Suharekës

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

"SELAMI ELSHANI" B.I. EMRI TREGTAR N.T.SH. "FLAMURI 1979"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Adem Jashari" p.n. — Suharekë
(Adresa)

Suharekë-Kosovë — 24000
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049894405 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Selami Elshani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

senat 092@hotmail.com
(Adresa elektronike)

N.T.SH. FLAMURI 1979 SUHAREKË

15.05.2019
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Hysni VESELI
(Emri i avokatit)

rruga"Nekibe Kelmendi" p.n Prishtinë - Hajvali
(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

15.05.2019
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Autoriteti Kontraktues Komuna e Suharekës me datë 11.02.2019 ka publikuar njoftimin për kontratë për projektin me titull: Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bilokimit të automyeteve në teritorin e Komunes se Suharekss dhe nr. Te prokurimit; 624-19-314-2-2-1 numri i mbrendshëm: 624-019-007-22]. Autoriteti Kortraktues ka pulikuar njoftimin B58 me të cilin ka njoftuar se ka shpërblyer me kontratë konzorcinmin "XONI' SH. P.K. & N.SH. "OSMANI" ndërsa neve na ka njoftuar si tenderues i pa suksesshem. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë 05.03.2019. Hapja e tenderit është bërë në të njejtën datë. Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin në të ulët në bazë të poentimit"

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Ne nuk kemi marrë pjesë në hapje të tenderit. Pas hapjes përmes platformës elektronike na Eshtë dërguar procesverbali i hapjes. Sa i përketë hapjes konsiderojmë se hapja është bërë në formë të rregullt.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pas vendimit të Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës Grupit të O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik. Autoriteti Kontraktues na ka ofruar disa dokumente, mirëpo sa i përketë raportit të vlerësimit me arësyetimin se nuk e lejon ligji që të jepet ky dokument ka refuzuar që të na siguroj raportin. Nga dokumentet të cilat na janë dhënë, kemi vërejtur se janë bërë shkelje gjatë vlerësimit dhe se grupi i O.E. I shpërblyer me kontratë është favorizuar edhe përkundër që ka ofruar tender të pa përgjegjshëm , sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë teknike, konkretisht nuk ka ofruar referenca në vlerë prej 60,000.00€.
Gjithashtu në bazë të dokumenteve që na janë ofruar kemi vërejtur se gjatë procedurës së prokurimit ka pasur edhe shkelje tjera procedural, andaj të pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 06.05.2019 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Me datë 07.06.2019 Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin me të cilin na ka refuzuar kërkesën tone dhe e ka lënë në fuqi vendimin e tyre për shpërblim me kontratë Grupin e O.E. "XONI' SH. P.K. & N.SH. "OSMANI"

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se gjatë procedurës së prokurimit në fjalë janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-s dhe Rregullave dhe Udhëzuesit të prokurimit si në vijim:

Neni 59 i LPP-s

Neni 69 i LPP-s

Neni 10 i LPP-s

Neni 57 i LPP-s

Neni 39 i Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit Neni 41. i Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit Neni 4. i Rregullave për tenderët jo nornealisht të ulët

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontratkutes gjatë vlerësimit të tenderit duke mos i marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ka bërë shkelje të këtij neni për shkak se nuk e ka bërë një vierësim të drejtë. Në dispozitat e nenit 59 paragrafi 4 shprehimisht është paraparë se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) nenin 7.1 & 7.2 është paraparë kërkesa 1.Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje) dhe si dëshmi është kërkuar 1. Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje), nga e cila rezulton se asnjëri nga anëtarët e grupit nuk e kanë veprimtarinë e aktivitetit të biznesit 5210-Magazinimi dhe Ruajtja, ndërsa në specifika teknike dhe përshkrimin e çmimit si paramasë është paraparë Deponimi i automjeteve. Pra duke mos e pasur në aktivitet të biznesit këtë pikë grupi i O.E. nuk e ka plotësuar këtë kërkesë dhe Autoriteti Kontraktues e ka marrë si të përgjegjshëm këtë grup edhe pse nuk i ka plotësuar kërkesat.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) nenin 9.1 & 9.2 është paraparë kërkesa si vijon: 1.Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 60.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. Si dëshmi për realizimin me sukses është kërkuar: 1.Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbali et e pranimit teknik.

Gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se grupi i O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" i kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe kanë vendosur që të njejtin ta shpërblejnë me kontratë, mirëpo në bazë të

dokumentacionit të cilin e ka ofruar grupi i O.E. fitues rezulton se ky grup nuk e ka plotësuar kërkesën e lartëcekur për arësye se grupi në tërësi ka ofruar dëshmi se ka përfunduar kontratë me autoritete publike në vlerë prej 17,171 00 € ndër të cilat ka transport të masës drusore e që nuk është e ngjashme me objektin e kontratës në fjalë. Si dëshmi grupi ka ofruar referencat përkatëse mirëpo të njejtat nuk e plotësojnë kërkesën minimale e cila ka qenë 60,000.00 €. Grupi i O.E. në listën e projekteve ka paraqitur kontrata fiktive të cilat i ka paraqitur me qëllim të vënies në lajthim të komisionit të vlerësimit dhe si dëshi ka ofruar referencat fiktive andaj duke mos kërkuar sqarim në lidhje me këto referenca konsiderojmë gë Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s.

Nga protokolli i bashkëpunimit në mes të "Sigma" Viena Insurance Group dhe anëtari i Grupit N.SH. "Osmani" të paraqitur nga ky i fundit shihet se është manipuluar me këtë document duke paraqitur informacione jo të vërteta përkatësishtë mashtruese me qëllim të vënies në lajthim të komisionit, pasi që në protokollin në fjalë shkruan se N.SH. "Osmani" do ti riparoj mjetet e aksidentuara, ndërsa referenca i është lëshuar si dëshmi për transportin e automjeteve për riparim.

Autoriteti Kontraktues duke pasur parasysh se Grupi i O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" kanë ofruar informacione të pa vërteta apo mashtruese është dashur që këtij grupi t'ia konfiskoj sigurimin e tenderit duke u bazuar në nenin 57 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-s

Në nenin 69 të LPP-s shprehimisht është paraparë që: 4.2 (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Grupi i O.E. O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" nuk ka ofruar dëshmi që ka siguruar shërbimet sikur i ka paraqitur në listën e projekteve por vetëm ka dorëzuar dokumente fiktive si kontrata të pa noterizuara dhe referenca fiktive nga firma me të cilat ka lidhje familjare apo marrëdhënie tjera shoqëpore . Pra Autoriteti Kontraktues duke i marrë për bazë këto referenca fiktive pa kurrëfarë dëshmie si faturë, raport bankar apo dokument tjetër që evidenton se ka përfunduar një kontratë e tillë e shpërblen me kontratë grupin e O.E. në fjalë dhe duke vlerësuar në këtë mënyrë konsiderojmë që ka bërë shkelje edhe të nenit 69 të LPP-s.

Në nenin 39 të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit në paraqitjen tabelare shprehimisht është paraparë që nëse lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vleres se përcaktuar duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm andaj me qenë se Grupi i O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, është dashur që tia refuzoj tenderin grupit në fjalë për shkak se nuk e ka mbërri vlerën minimale të kontratave të realizuara. Pra duke pasur parasysh atë që u cek më lartë konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe të dispozitave të këtij neni.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe të nenit 41. të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit duke e neglizhuar vlerësimin e këtij tenderi. Hapja e tenderit është bërë me 05.03.2019 ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues është bërë me dt. 30.04.2019 pra si pasoj e neglizhencës vlerësimi është vonuar 51 ditë ndërsa në bazë të dispozitave të nenit në fjalë ësht dashur që të vlerësohet tenderi brenda afatit prej 30 ditëve nga data e hapjes së tenderit dhe në veqanti nëse natyra e prokurimit në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në vecanti për kontratat e një natyre

komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Autoriteti Komtraktues i ka kaluar të gjitha afatet e parapara edhe pse kjo procedure nuk mund të quhet procedurë komplekse sepse të gjitha kushtet dhe kriteret kanë qenë të parapara, gjithashtu edhe specifikat kanë qenë të qarta pra nuk ka vend që kjo procedure të konsiderohet komplekse, por edhe po të qëndronte një gjë e tillë Autoritetit Kontraktues duhet të na kishte njoftuar me shkrim në lidhje me këtë qështje andaj konsiderojmë që ka bërë shkelje edhe të këtij neni.

Pasi kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit në fjalë kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarim nga Grupi i O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANT" në lidhje me tenderin jo normalisht të ulë:

Në nenin 4. të Rregullave për tenderët jo nermalisht të ulët në paragrafin 4.4. është

paraparë dispozita si në vijim:

Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhinatarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose tëmetodave të ndërtimit;

4.4.2 Çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 7

4.4.3Çfarëdo kushte vecanërisht të fevorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, Sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

4.4.4 -Origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Nga përgjigjia e Grupit të O.E. "XONI' SH.P.K. & N.SH. "OSMANT"vërehet se nuk ka kurrëfarë baze me të cilën do ta realizon Kontratën në fjalë për arëyse se çmimi i tenderit te tyre është shumë i ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe se nuk ka kurrëfarë baze për të marrë në konsideratë pikat e lartëcekura të kërkuara per tenderët jo normalisht të ulët. Andaj një sqarim qesharak nga O.E. është dashur që të refuzohet sepse çmimi i dhënë nuk i mbulon shpenzimet e karburantit e lëre më shpenzimet tjera të amortizimit, pagesën e punëtorëve etj. pasi që arësyetimi i tyre se venddeponimin e kanë 1.7 km nga qendra e qytetit dhe shpenzimet për një transport nuk e tejkalojnë shmën prej 1.2 Euro nuk janë as për së afërmi realitetit pasi që territori i Komunës së Suharekës përfshinë fshatra dhe shtrihet në një hapësirë prej 361 km2 andaj nuk duhet llogaritur vetëm hapësirën prej qendrës deri tek deponimi për zhvendosje të automjeteve, por duhet pasur parasysh nëse një aksident ndodh psh. në fshatrat Maqitev, Budakovë, Dolloc etj. ku distanca nga qyteti është së paku 16 km dhe shpenzimet vetëm të karburantit e kapin vlerën e përafërt prej 20 litra naftë. Autoriteti Kontraktues në sqarimin e tyre ka cekur se vendi i kryerjës së shërbimeve është Komuna e Suharekës, e që nënkupton se këto shërbime do të kryhen në tërë territorin e komunës, ndërsa arëyetimin e grupit të O.E. fitues e ka marrë si të mjaftueshëm edhe pse e ka cekur vetëm distancën nga qendra deri te deponimi i zhvendosjes së automjeteve.

Andaj duke e pranuar një arësyetim të tillë nga O.E. Autoriteti Kontraktues është dashur që të bazohet në dispozitat e nenit 4 pika 4.6.2 nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit

abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues me pranimin e një oferte abnormalisht të ulët ka dëmtuar edhe buxhetin e vetë sepse në specifika teknike është paraparë që për qdo bartje O.E. ti paguaj 5 % të vlerës së faturës.

Nga Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik, mirëpo nuk na janë ofruar disa dokumente me arësyetimin se dhënia e dokumenteve si Raporti i vlerësimit të tenderit përbën shkelje t LPP-s andaj konsiderojmë se është bërë edhe shkelja e nenit 10 të LPP-s

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, ***kërkojmë*** nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta detyroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht ta pezulloj procedurën e prokurimit në fjalë, duke u bazuar në faktet e paraqitura më lartë të aprovoj kërkesën tone si të bazuar, vendimin për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues ta anuloj dhe lendën ta kthej në rivlerësim me detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të evitoj shkeljet e procedurës gjatë vlerësimit të tenderit dhe të na shpërblej me kontratë neve si O.E. i vetëm i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me shkeljet e lartëcekura do të na shkaktohen dëme të konsiderueshme sepse janë bërë shpenzime për përgaditjen e ofertës tonë, shpenzime të kësaj ankeses si dhe fitimin e humbur në rastë se do të shpërbleheshim me kontratën në fjalë. Dëme do ti shkaktohen edhe vetë Autoritetit Kontraktues sepse ka paraparë fitimin prej 5% të vlerës së faturës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*